

STATUT
I
SHOQËRISË

“R & R” SHPK.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA

Neni 1
Emërtimi dhe Themelimi

1. Emri Shoqërisë është **“R & R” SH.P.K**
2. Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.
3. Ortak i Vetëm, themelues i shoqërisë është **Ilir REKA**
4. Data e themelimit është **19.03.2021.**

Neni 2
Objekti

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të paisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike etj. Të ideojë, zbatojë dhe të menaxhoje rrjete të telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave dhe interkoneksionet në përgjithësi. Të plotësojë nevojat industriale, tregtare, sociale dhe të rezidentëve për shërbime telekomunikacioni gjithëpërfshirës dhe efektiv. Të kënaqë të gjithë kërkesat praktike dhe të arsyeshme për këto shërbime. Të sigurojë shërbime konsulence, këshillimi, supervizimi, trajnimi dhe kontrata shërbimi. Të interkonjektohet me ofrues të tjerë shërbimesh dhe shoqëri të telekomunikacionit për të furnizuar shërbime end-to-end. Të kryej cdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe me pasuri të paluajtshme si edhe cdo aktivitete tregtare financiare dhënie me qera ose lënie peng i cili mund të konsiderohet si i dobishëm dhe i nevojshëm. Të blejë direkt ose indirekt interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë një qëllim të njëjtë me atë të shoqërisë në Shqipëri ose jashtë saj. Të kryejë cdo gjë që shoqërisë i duket e nevojshme e leverdishme ose e rastësishëm për të arritur qëllimin e saj. Shërbime informatike dhe telefonike, shpërndarje internet dhe konektivitet. Krijim dhe shpërndarje programe kompjuterike. Konsulencë teknike dhe riparim paisje kompjuterike dhe elektronike. Tregtim, import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të



fonisë, sistemeve të alarmit kundra vjedhjes, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve aparaturash mjeksore, sistemeve UPS, stabilizatorët, gjeneratorët, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike, sistemeve autovizive etj. Programim software, ushtrimi i aktivitetit në fushën e teknologjisë së informacionit, veçanërisht në ndërtimin, tregtimin dhe reklamimit të faqeve të internetit dhe/ose çdo aktiviteti tjetër tregtar në këtë fushë. Ushtrimin e aktivitetit të konsulencës në fusha të ndryshme ligjore, sociale, historike dhe/ose të cdo natyre tjetër, sipas rastit. Çdo aktivitet tjetër tregtar dhe biznesi i cili lejohet nga legjislacioni shqiptar i zbatueshëm e në fuqi.

Neni 3 **Ortakët e shoqërië**

1. Shoqëria është themeluar nga një Ortak i Vetem, **Z.Illir REKA**.
2. **Z.Illir REKA**, si Ortak i Vetëm, përgjigjet për humbjet e shoqësi deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj.
3. Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 4 **Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e Shoqërisëdo të jetë pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me rregullat e përcaktuar nga ky Statut.

Neni 5 **Selia**

1. Selia e Shoqërisë "**R & R**" **SH.P.K** ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake Nr.8- Tiranë, Rruga "4 Dëshmorët", Apartamenti 17, Kodi Postar 1017.
2. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.



KREU II KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 6 Kapitali

1. Kapitali i shoqërisë është 100.000(njëqind mijë) lekë.
2. Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (një) kuotë.
3. Vlera nominale e një kuote është 100.000(njëqind mijë) lekë.
4. Ortaku i Vetëm është zotëruesi i të gjitha kuotave të shoqërisë, në vlerën 100% të tyre.
5. Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letrat me vlerë.
6. Cdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote.

Neni 7 Regjistri i kuotave të kapitalit themeltar

1. Shoqëria mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të kuotave të shoqërisë, si: emri e mbiemri i Ortakut të Vetëm, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e kuotave dhe data e kryerjes së regjistrimit.
2. Forma dhe modalitet e tjera të regjistrimit miratohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
3. Në rast të zotërimit të kuotave të shoqërisë nga më shumë se një ortak forma dhe modalitet e tjera të këtij regjistri miratohen me vendim të ortakëve që zotërojnë më shumë se $\frac{3}{4}$ e kuotave.

Neni 8 Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnet të Ortakut

1. Ortaku i Vetëm mund të transferojë lirisht tek të tretët, pjesërisht apo tërësisht, pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Në rast se në një moment të caktuar pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë zotërohen nga më shumë se një ortak, transferimi i këtyre pjesëve brenda shoqërisë mund të bëhet lirisht ndërsa transferimi tek personat e tretë mund të bëhet vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 9 Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi

1. Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, ndërmjet trashëgimisë, si dhe midis bashkëshortëve në rast ndarje pasurore.
2. Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, midis bashkëshortëve si dhe midis prindit dhe fëmijës ose anasjelltas.



Neni 10

Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar

1. Në cdo rast transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet të vërtetohet nëpërmjet një akti noterial.
2. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar pasqyrohen në regjistrin e posacëm të miratuar sipas nenit 8 të këtij Statuti. Mos pasqyrimi i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar në këtë regjistër, nuk e bënë të pavlershëm aktin e transferimit.
3. Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar duhet të depozitohet në Regjistrin Tregtar jo më vonë se një muaj nga data e regjistrimit të këtij akti në zyrën noteriale përkatëse.
4. Kërkesa për depozitim të aktit të shitjes së pjesëve të kapitalit themeltar mund të bëhet nga shitësi ose nga blerësi, ose prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

Neni 11

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar me anë kontributeve në para

1. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet me kontribute në para me vendim të Ortakut të Vetëm.
2. Zmadhimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet me shlyerjen tërësisht të vlerës së shtuar prej Ortakut të Vetëm.
3. Shlyerja e fondeve mund të vërtetohet nga një zyrë noteriale ose nëpërmjet një konferme bankare.
4. Në rast se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet brenda 6 muajve nga data e depozitimit të fondeve, Ortakut të Vetëm i lind e drejta të tëheqë fondet e depozituar.

Neni 12

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar me anë kontributeve në natyrë

1. Zmadhimi i kapitalit themeltar nëpërmjet kontributeve në natyrë bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm.
2. Vlera e kontributeve në natyrë si shtesë e kapitalit themeltar përcaktohet nga një ekspert i cili emërohet nga Ortaku i Vetëm.
3. Të dhënat mbi kontributin në natyrë të shtuar si pjesë e kapitalit themeltar pasqyrohen në Statut dhe regjistrohen në Regjistrin Tregtar. Në rast të kundërt zmadhimi konsiderohet i pa bërë.



KREU III
ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13
Organet e Shoqërisë

1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
 - a. Ortaku i Vetëm
 - b. Administratori

Neni 14
Ortaku i Vetëm, kompetencat

1. Ortaku i Vetëm ka këto kompetenca:
 - a. përcaktimin e politikave tregtare;
 - b. ndryshime të statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorit;
 - d. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
 - f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - h. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - i. shpërndarjen e dividendëve;
 - j. transferimi i kuotave të kapitalit themeltar tek palet e treta;
 - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

Neni 15
Administratori i Shoqërisë

1. Administratori ka për detyrë:
 - a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b. të përfaqësojë shoqërinë në marrdhëniet me të tretët;
 - c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, si dhe miratim e tyre dhe shpërndarjen e fitimeve;
 - e. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - f. të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë;



- g. zbatimin e politikave tregtare si dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
 - h. te hartojë dhe miratojë strukturën e organizimit të shoqërisë dhe rregulloren e funksionimit të saj;
 - i. të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratori ka për detyrë:
 - a. Që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.
 - b. për të vepruar në emër të shoqërisë.
 3. Mandati i Administratorit të shoqërisë është 5(pesë) vjet me të drejtë rizgjedhje.
 4. Administrator i shoqërisë është **Z.Illir REKA**.

Neni 16 **Marrdheniet me të tretët**

1. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga Administratori edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit kapërcen objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke patur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e Administratorit duhet të respektohen nga të tretët.
2. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Administratori ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

Neni 17 **Përfundimi i detyrës së Administratorit**

1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
 - a. Mbaron afati për te cilin është emëruar në detyrë;
 - b. Shkarkohet nga detyra;
 - c. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
 - d. personi vuan apo mund të vuajë nga ç'rregullime mendore;
 - e. personi jep dorëheqjen nga detyra.



**KREU IV
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**Neni 18
Prishja dhe likuidimi**

1. Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

**Neni 19
Baza ligjore**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 20
Mosmarrëveshjet**

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I VETËM

Z.Illir REKA

